

VENDIM
Nr.51, datë 24.8.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALB WIND ENERGY” SHPK PËR AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE
SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA ANA E TYRE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr.44, datë 24.7.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 pika 1 germa “a” dhe neni 19, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 24.8.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me ERE (Park Eolik VISU dhe TERPAN), si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-S
Bujar Nepravishta